



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Nr. prot.

3946/1

Tiranë, më 24.11.2017

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1588, datë 08.11.2012.

SHOQËRISË “BICI” SH.P.K
Lagjia “Demokracia”, Mamurras, Kurbin, Qarku Lezhë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHM
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Bici” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1588, datë 08.11.2012 për mineral gurë gëlqerorë në objektin “Shpërdhet”, Kurbin, Qarku Lezhë.

Nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore me shkresën nr.4204, datë 15.05.2017 protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.3946, datë 17.05.2017 dhe me shkresën nr.5823, datë 27.07.2017 protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5403, datë 01.08.2017 është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1588, datë 08.11.2012 për mineral gurë gëlqerorë në objektin “Shpërdhet”, Kurbin, Qarku Lezhë, për arsye se nuk janë kryer pagesat e rehabilitimit vjetore për vitin 2013-2014, për vitin 2014-2015, për vitin 2015-2016, dhe për vitin 2016-2017, përcaktuar sipas pikës 5, të nenit 31 të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur gërmën “ç”, të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1588, datë 08.11.2012, për mineral gurë gëlqerorë në objektin “Shpërdhet”, Kurbin, Qarku Lezhë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1588, datë 08.11.2012, për mineral gurë gëlqerorë në objektin “Shpërdhet”, Kurbin, Qarku Lezhë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

Damian Gjikhuri

